

Raporti Narrativ Vjetor 2017**1. Informacion i përgjithshem**

Periudha: Janar 2017 – Dhjetor 2017

Emri i organizatës: “Udhëtim i Lirë – Liberi di viaggiare”

Adresa zyrtare: L. 3 Rr. Egnatia Nr 109, Durrës

Kodi postar: 2001

E-mail: liberidiviaggiare@yahoo.it

Faqja web: www.udhetimiilire.org

Person kontakti: Miranda Mansaku

E-mail: mir_elezi@yahoo.com

Phone number: ++355695720494

1. Përmbledhje e aktivitete të realizuara

1.1 Projekte të implementuara dhe në proces

- Shoqata “Udhëtim i lirë” që nga periudha Maj 2017, ka nisur implementimin e dy projekteve.

Projekti “*Qytetarë aktiv në monitorimin dhe përmirësimin e qeverisjes vendore në Bashkinë e Shijakut*”, i cili shtë zbatuar gjatë hakrut kohor 1.05.2017 – 31.10.2017, është mbështetur nga fondi i nën-grantimit "Lot 1- Anti-korrupsioni dhe zhvillimi i kapaciteteve" në kuadër të projektit CIVILISC, zbatuar nga IDM, financuar nga BE.

Në kuadër të këtij projekti u ndërmorrën këto aktivitete:

- *takime me bazë komunitare me target grupe të ndryshëm të zonës së Shijakut*
- *fokus grupe dhe intervista me antarë të ndryshëm të komunitetit (biznese, ndërlidhësa komunitarë, ëprfaqësues të strukturave shtetërore lokale etj) me qëllim evidentimin e nivelit të kënaqësisë së shërbimeve të ofruara nga pushteti lokal ndaj qytetarëve.*
- *hartimi i një raport vlerësimi mbi shërbimet publike në Bashkinë Shijak*
- *takime ndërgjegjësuëse mbi rëndësinë e pjesëmarrjes qytetare në qeverisjen publike dhe nxitjen e llogaridhënies nga ana e struktrave të pushtetit lokal ndaj qytetarëve*

➤ Në muajin Tetor 2017, shoqata ka filluar implementimin e projektit “*Youth Eco Act*” i cili do të shtrihet deri më 33.09.2018. Ky projekt është i mbështetur nga Grantet Operacionale të programit "Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile në fushën e Mjedisit në Shqipëri (SENiOR-II) që zbatohet nga REC - Qendra Rajonale e Mjedisit në Shqipëri, mbështetur dhe financuar nga Ambasada Suedeze në Tiranë.

Në kuadër të këtij projekti janë realizuar :

- *Vendosja e koshave të diferencuar në shtet arkeologjike të qytetit dhe në disa shkolla target të projektit ;*
- *Trajnime me grupin e vullnetarëve mbi rëndësinë e edukimit mjedisor dhe riciklimit ;*
- *Takime ndërgjegjësuëse me nxënës të shkollave të mesme, target të projektit ;*
- *Hartimi dhe publikimi i planit strategjik të shoqatës ;*
- *Projekte të tjera në vazhdimësi*

1.2 Aktivitete të tjera të realizuara në kuadër të nismave të ndryshme

Mars 2017

- Ekspozita me foto “Turizmi i Qëndrueshëm 2017”, me nxënës të shkollave të mesme të qytetit, zhvilluar në Galerinë “Nikolet Vasia” - në bashkëpunim me Bashkinë Durrës dhe Drejtorinë Arsimore Rajonale. Në këtë nismë, shoqata ishte promotore dhe mbështetëse si dhe siguroi shpërndarjen e çmimeve të 3 vendeve të para.
- Tryezë e rumbullakët mbi negociatat e Shqipërisë me BE - në dhe rolin që të rinjtë mund të luajnë në këtë proces, zhvilluar në ambientet e Këshillit Bashkiak Durrës - në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar dhe Bashkinë Durrës. Në këtë takim morën pjesë stafi drejtues dhe vullnetarë të rinj të shoqatës.

Prill 2017

- Aktivitet sensibilizues me rastin e 22 Prillit 2017, Ditës Ndërkombëtare të Tokës “Për një botë të pastër” - në bashkëpunim me Bashkinë Durrës, Drejtorinë Arsimore Rajonale, shoqatën Mirësia, Shkollën Frymë Dashurie dhe Earth Day Network. Ky aktivitet u promovua drejtpërdrejtë në rrjetin ku shoqata bën pjesë. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte sensibilizimi i të rinjve në mbrojtje të vlerave mjedisore, përmes aktivitetve kreative.
- Edukim mbi vlerat arkeologjike dhe kulturore të qytetit, për të rinjtë nga grupe vulnerabël. Për këtë qëllim është realizuar nje tour në sitet arkeologjike të Durrësit me fëmijë jetim të qytetit.
- Ekspozita e pikturës “Gavril Priftuli 2017” me nxënësit e shkollës Jan Kukuzeli, zhvilluar në Galerinë “Nikolet Vasia”- në bashkëpunim me Bashkinë Durrës dhe Drejtorinë Arsimore Rajonale. Tashmë një traditë për qytetin dhe shoqatën e cila ka në fokus të vazhdueshëm edukimin mbi vlerat kulturore të qytetit, duke përdorur artin si një mjet.
- Pjesëmarrje në Konferencën: "A step together forward cooperation" në kuadrin e iniciativës Rezoluta e Rinise, zhvilluar në ambientet e Pallatit të Kulturës Durrës - në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar dhe Bashkinë Durrës. Në këtë nismë shoqata, ishte një pikë ndërlidhëse midis të rinjve të qytetit, duke siguruar një pjesëmarrje aktive të këtij target grupi.

Qershor 2017

Pjesëmarrje në programin e shkëmbim eksperiencash midis organizatave të financuara nga IDM, ku përfaqësues të stafit drejtues të shoqatës morën pjesë në vizitën studimore në Sofje.

Shtator 2017

- Java Europiane e Lëvizshmërisë 17 - 22 Shtator 2017 në bashkëpunim me Bashkinë e Durrësit dhe OJQ të tjera në Durrës, nën mbikëqyrjen e Zyrës së BE-së në Tiranë. Ky aktivitet inicioi me ndërgjegjësim të nxënësve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit, jo vetëm për një pjesëmarrje aktive por dhe për të shpalosur këndvështrimet e tyre mbi rëndësinë e lëvizshmërisë për një mjedis të pastër dhe jetë të shëndetshme. Aktiviteti u finalizua në ambjentet e jashtme të pallatit të kulturës, ku morën pjesë nxënës të shkollave të ndryshme, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të strukturave të pushtetit lokal, media etj.
- Konkursi i eseve "Lidershipi në shoqërinë civile" me studentët e universiteteve shqiptare dhe kosovare, në bashkëpunim me Shoqatën për Zhvillimin e Lidershipit Shqipëri dhe Kosovë, YouCare dhe Kongresin Rinor Kombëtar. (24 Shtator - 07 Tetor 2017).

Tetor 2017

- Konkursi me foto nën sloganin: “Verë 2017” realizuar më datë 17 Tetor, me nxënësit e shkollave të mesme, zhvilluar në bashkëpunim me Bashkinë Durrës, Drejtorinë Arsimore Rajonale dhe Studion e fotove “Iliria”. Ekspozita u zhvillua si çdo vit në Galerinë “Nikolet Vasia”. Shoqata financoi dhe 3 çmimet fituese si dhe certifikatat e pjesëmarrjes për të gjithë nxënësit pjesëmarrës.

Nëntor 2017

- Pjesëmarrje në shkëmbimin e eksperiencave në Berlin, në kuadër të “Ideas and Actions for Europe: Environment and Energy in the 21st Century”, mbështetur nga CDI.
- Pjesëmarrje në shkëmbimin e eksperiencave mbi “Youth Forum” mbështetur nga Zyra Franko-Gjermane (DFAJ).

2. Pjesëmarrje në aktivitete të tjera në kuadër të bashkëpunimeve me struktura dhe donatorë të ndryshëm

Seminar “Parimet e Administrates Publike-Seminar per Organizatat e Shoqërise Civile », organizuar nga IDM, në bashkëpunim me SIGMA, OECD, -8 Shkurt 2017.

Tryeze e rrubmullaket “Te Rinjte dhe Negociatat me BE”- 8 shkurt 2017

Trajnimi mblodhi bashke të gjitha organizatat e Kongresit Rinor Kombetar dhe kishte si synim te informonte dhe edukonte organizatat rinore ne Shqiperi rreth negociatave për antarsimin në BE, ndikimin qe te rinjtë dhe politikat rinore kanë në këtë proces, si dhe kontributin konkret të tyre.

Konferencë “Teknologjia ne re (cloud) ndihmon shoqëritë” 07 Mars 2017

Në këtë konferencë u prezantuan sfidat me te cilat ballafaqohen OJF në Shqiperi dhe shembuj te mire se si teknologjia u mundëson OJF që të punojnë me lehtë dhe te realizojnë misionin e tyre me shpejte. Disa OJF-te vendase pranuan të zbatonin këto teknologji për herë të parë.

Takim: “Mbështetje për koordinimin e Rrjetit Kombëtar Shqiptar”-13.03.2017

Qëllimi i këtij takimi ishte përfshirja në Rrjetin kombetar Shqiptar, një strukturë e pavarur dhe autonome, një struktur e përhershme, pjese e Rrjetit te Fondacionit Anna Lindh, që funksionon në kuader te Partneritetit Euro-Mediterran .Ky rrjet është i përbërë nga individë, NGO, institucione Publike, përfshirë dhe autoritete lokale dhe rajonale .

Seminar: “Qeverisja me pjesëmarrje”- 10 mars 2017

Seminari mbështetej nga Partneret Shqiperi per Ndryshim e Zhvillim dhe adresonte rëndësinë e përfshirjes së publikut në vendimmarrjen lokale, ku pjesëmarrësit u njohën me të drejtat dhe detyrimet qe qytetaret kanë në qeverisjen demokratike dhe sigurimin e mundësive për qytetaret qe te marrin pjese ne menyre aktive ne adresimin e çështjeve të interesit publik përmes ndikimit te vendimeve ne nivelin vendor e qendror.

Takim i 5-te i Grupit të Menaxhimit te Integruar te Politikave te Mireqeverisjes dhe Administrimit Publik 17.03.2017

Në zbatim te pikes 2 të Urdherit nr.129 datë 21.09.2015 te Kryeministrit “Për marrjen e masave institucionale dhe operacionale për zbatimin e qasjes sektoriale dhe krijimin e grupeve te menaxhimit te integruar te politikave, Ministri i Shtetit per Inovacionin dhe Administraten Publike dhe Ministri i Shtetit per Çështjet Vendore, zhvilloi takimin e peste të ketij grupi në sallën e mbledhjeve pranë Kryeministrise.

Konferencë “A step together forward cooperation”, zhvilluar më 09.04.2017

Në kuadrin e iniciatives Rezoluta e Rinise, u zhvillua kjo konferencë ku të rinjte treguan se pertej bindjeve politike kane problematika, interesa të perbashketa, dhe mbi te gjitha vullnet per te gjetur zgjidhje per problematikat rinore. Konferenca solli së bashku gjashte forumet Rinore të partive Politike, perkatesisht Forumin Rinor Eurosocialist, Forumin Rinor të Partisë Demokratike, Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet, Partisë Republikane, Levizjen Rinore Ambientaliste , Levizjen Rinore

per Integrim si dhe Kongresi Rinor Kombetar, me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert dhe Fondacionit Konrad Adenauer.

Takim “Nderveprimi dhe dialogu me qytetarët e territorit prites”, në kuader të projektit IN.TO.EU -2.05.2017

Bashkia Durrës në partneritet me Bashkite Palazzo di San Gervasio Itali, Teruel Spanje dhe Olimpia e lashte Greqi, në zbatim të projektit IN.TO.EU, zhvilloi kete takim informativ. Ky i fundit ka për qëllim përballjen dhe analizën e emigracionit në nivelin European dhe lokal duke u fokusuar veçanërisht në promovimin e dialogut si dhe rritjes së shkallës së ndërgjegjësimit ndërmjet aktoreve privat dhe publik lidhur me fenomenin e emigracionit.

Dëgjese publike mbi buxhetin 2018-2020, date 2.05.2017 në ambjentet e Bashkisë Durrës.

Kjo dëgjese lidhej me investimet, projektet dhe shërbimet kryesore të programit “Zhvillimi Ekonomik dhe i Territorit” që Bashkia mendon të vërë në zbatim për vitin 2018-2020. Ky institucion duhet të krijojë mundësitë për pjesmarjen e publikut dhe të gjitha palëve te interesuara në procesin e hartimit të buxhetit vjetor dhe sidomos te prioriteteve buxhetore. Kjo dëgjese është bërë e mundur përmes asistimit nga ISB (Instituti i Studimeve Bashkohore) nepermjet financimit te DLDP-se (Decentralization and Local Development Programme) për përgatitjen e buxhetit afatmesem.

EUROPE DAY: date 9.05.2017 Tiranë

Takim në përkujtim të Ditës së Europës, me ratsin e përvjetorit të 6 (gjashtë) te Traktatit te Romes, ku u vendosën themelet per nje Bashkim European te cilin njohim NE sot. Modeli i Bashkimit European, që u organizua ne 8-9 Maj 2017, realizoi një konferecë me qëllim rishikimin e disa prej aritjeve të Bashkimit European, për te premtuar bashkëpunim paqësor, respektimin e dinjitetit njerëzor, lirinë, demokracinë, barazinë dhe solidaritet ndërmjet kombeve Europiane dhe Ballkanit Perëndimor.

Seminar “Monitorimi efektiv i politikave publike”, 23-26.05.2017

Qëllimi i ketij seminari ishte forcimi i kapaciteteve te organizatave të shoqerise civile dhe zgjerimi i njohurive te tyre mbi reformen ne administraten publike, poliktikave publike si dhe praktikat e suksesshme të organizatave studimore ne Bashkimin European dhe vendeve te Vishegradit (V4) per formëzimin dhe monitorimin e politikave publike, standarte të politikë berjes dhe koordinimit të zbatimit të tyre.

Seminar/Memorandum Bashkpunimi -23-26 Maj 2017

Grupet Kombetare te Punes mbi RAP – Platforma WEBER

Synimi i ketij Memorandumi Bashkëpunimi ishte ngritja e një stukture për krijimin dhe funksionimin e Grupit Kombëtar te Punes (GKP) mbi reformen e Administrates Publike (RAP) ne Shqiperi, mbështetur nga Projekti Mundësues për Shoqerinë Civile ne Ballkanin Perëndimor per monitorimin e reformes së Administrates Publike.

Qëllimi i GKP-se ishte marrja pjese ne diskutime dhe konsultime mbi raportet monitoruse te RAP në nivelin komberar dhe rajonal, të cilat do të hartohen si pjese e projektit Weber si dhe për të adresuar te gjitha çështjet e tjera të rendesishme ne fushen e RAP në Shqiperi.

Forum “ Investigimi i zbatimit në praktikë i legjislacionit për ruajtjen e natyres ne Shqiperi” 07 Qershor 2017

Ky forum u zhvillua nga REC dhe Instituti per ruajtjen e Natyres ne Shqper (INCA) mbi finalizimin e projektit “ Fuqizimi i OMSHC-ve shqiptare për promovimin dhe ruajtjen e natyres ne Shqiperi ”. Aktivitet i zhvilluar në kuader te programit ACHIEVE, zbatuar nga REC dhe financuar nga BE (Delegacioni ne Shqiperi).

Forum Publik me Kandidatat per deputet per qarkun e Duresit, 08 qershor 2017

Pop 2017 –Përballja e ofertave politike

Projekti “POP “ ishte nje nisme e organizatave te shoqerise civile ne 9 rajone të Shqiperisë per mobilizimin e qytetarve, veçanerisht të rinjve dhe grave, per identifikimin e nevojave dhe prioriteteve te komuniteteve dhe adresimin e çeshtejeve specifike kandidateve të partive politike ne zgjedhjet Parlamentare 2017. Në këto forume publike, kandidatet për deputet dhe perfaqesuesit e forcave politike per Duresin patën mundesi te prezantojn programet e tyre, të mbrojnë avantazhet e ketyre programeve dhe te dialogonin me pjesëmarrësit.

Workshop “Drejt nje Axhende te Re Rurale“, 8 Qershor 2017

Workshopi i cili u realizua në sallën e keshillit Bashkiak Dures, ishte pasues i takimit informues i zhvilluar ne muajin Prill për Promovimin e Parlamentit te pare Shqiptar, me synim krijimin e nje hapësire diskutimi dhe shkembimi pervojash të aktoreve të ndryshem në nivel vendor rreth platformes se sfidave te zhvillimit rural, si dhe te orientoje aktoret rreth modeleve dhe praktikave europiane të zhvillimit.

Prezantim i iniciativave «Promovimi i fuqizimit të të rinjve të Ballkanit perëndimor» një iniciativë e Strategjisë europiane rinore- 9 Qershor 2017

Trajnim 3 ditor “Marredheniet me Publikun dhe Median per Organzatat e Shoqerise Civile ” 5-7 Korrik

Ky trajnim u zhvillua në qytetin e Pogradecit, u mbështet financiarisht nga zyra e TACSO.

Ditë informuese dhe thirrje per projekt propozime “Pjesmarrja Sociale e të rinjve në nevoje dhe minoriteteve” 24 Korrik 2017

Sesion Informimi mbi projektin “Zhvillimi dhe Bashkepunimi i Pershpejtuar i Shoqerise Civile ” nga USAID, zhvilluar ne ambjentet e Bashkise Durrës.

Trajnim mbi Procedurat e Aplikimit per Grante nga Programi EIDHR CBSS 2016-2017, 17-18 Gusht 2017

Në këtë trajnim organizatat pjesëmarrëse u njohën me objektivat dhe pritshmerite e programit EIDHR dhe kriteret e thirrjeve per propozime.

Prezantimi i gjetjeve per Shqiperine, zhvilluar nga IDM-11 shtator 2017

Takimi kishte si qëllim prezantimin e gjetjeve mbi Shqipërinë në lidhje me Indeksin e Qendrueshmerise se OSHC-ve 2016 per Europen Qendrore e Lindore dhe Euroazine. Ky takim shërbeu dhe si një forum me diskutime nga pjesëmarrësit.

Seminar advokues -25 Shtator 2017

Ky seminar është zhvilluar ne sallen e Keshillit te Qarkut, me temë “Autoritetet vendore per nje qeverisje me te mire vendore », në kuadër të projektit “Monitorimi i programeve te transparences ne nivel lokal per nje qeverisje demokratike ». Ky projekt eshte zbatuar nga Shoqata Kombëtare e Punonjesve Social me mbeshtetjen financiare të Programit të Granteve te vogla të Komisionit për Demokraci.

Mbyllja e projektit “Different local communities, same youth perspective », 29 Shtator 2017

Në kuader te përfaqesimit te te rinjve dhe pushtetit lokal ne kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale, Këshillin e Europes për 2017, u realizua përmbyllja e projektit. Albanian Youth Delegate si pjese integrale e ketij formati ka zhvilluar nje sere aktivitetesh me te rinjte e senateve akademike të universiteteve publike të Durrës, Elbasanit dhe Tiranës dhe nenpunës pergjegjes të politikave rinore në bashkitë dhe qarqet respektive.

Prezantimi i projektit “Te njohim NJMF ne zonen tone permes hulumtimit narrativ dhe vizual ” 4 Tetor 2017, zhvilluar nga CSDC, Durrës.**Workshop “ Project design” 9-10 Tetor 2017**

Ky workshop u realizua nga Terres des hommes në bashkëpunim me Institution për dialogun strategjik (ISD) dhe Beder University, rreth implementimit te projektit « Fuqizimi i shoqërisë civile për zhvillimin e reziliencës tek të rinjtë ndaj esktrimizmit të dhunshëm » financuar nga EU.

Takimi i parë lokal “ Politikat dhe Praktikrat e Migracionit ne Nivel Kombetar” 13.10.2017

Ky takim i zhvilluar në kuader te projektit REACT, u organizua nga Bashkia Durrës dhe Universteti “Aleksander Moisiu” ne partneritet me bashkite Katerini-Greqi, Bashkinë e Watterelos-France, Bashkite Gornja Rjeka dhe Brezncki Hum-Kroaci, dhe me pjesëmarrjen e 4 organizatave jo fitimprurese.

Mbyllja e Projektit TACSO, zhvilluar pranë EU Info Center, 9 Nëntor 2017**3. Anetaresime në rrjete**

Shoqata “Udhëtimi i lirë” është pjesë e disa rrjeteve si më poshtë:

- ✓ Anëtare e rrjetit ndërkombëtar Anna Lindh Foundation.
- ✓ Anëtare e Kongresit Rinor Kombëtar.
- ✓ Anëtare e rrjetit ndërkombëtar Earth Day Network.
- ✓ Anëtare e GKP (Grupit Kombëtar të Punës) për RAP (Reformën në Administratën Publike).
- ✓ Anëtare e Platformës së Bashkëpunimit Rinor të Ballkanit Perëndimor.

4. Partnerë të organizatës

Shoqata “Udhëtimi i lirë” ka ndërtuar një bashkëpunim dhe mbështetje nga struktura të ndryshme, të cilat janë pjesë e nismave dhe projekteve që janë implementuar dhe po implementohen kjo e fundit:

- ✓ Bashkia Durrës (Marrëveshje bashkëpunimi datë 27.04.2017 Nr. 9591 Prot)
- ✓ Këshilli i Qarkut Durrës (Marrëveshje bashkëpunimi datë 22.08.2017 Nr. 975 Prot)
- ✓ Bashkia Shijak (Marrëveshje bashkëpunimi datë 21.08.2017 Nr. 2992 Prot)
- ✓ Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës
- ✓ Shkolla e mesme e përgjithshme “Naim Frasheri” Durrës
- ✓ Shkolla e mesme e përgjithshme “Gjergj Kastioti” Durrës.

5. Donatorë

Shoqata “Udhëtimi i lirë” ka pasur është mbështetur financiarisht në iniciativat e saj, nga:

- ✓ IDM (Institute for Democracy and Mediation) përmes fondeve EU,
- ✓ REC përmes programit Senior,
- ✓ Bashkia Durrës